




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



„Radio Kaçaniku“
Pronar – Bedri ELEZI
Radio KAÇANIKU
Rr/ Vëllezërit Çaka, p.n.
Kaçanik

Ref:1612/1292/KPM/am

VENDIM

për ripërtitjen e licencës së transmetimit të Radio Kaçaniku, me seli në Kaçanik

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Kaçaniku ka qenë subjekt transmetues me mbulueshmëri lokale, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në Komunën e Kaçanikut, me seli në Kaçanik, në regjionin e Gjilanit. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Kaçaniku.
3. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës së Radio Kaçaniku ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga KPM brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më datën 11 maj 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e njoftuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen.
5. Njoftime të ngjashme me shkrim janë ridërguar tek Radio Kaçaniku edhe më 28 qershor 2016 dhe më 10 gusht 2016, me qëllim të nxitjes së kandidatit në fjalë për të vepruar në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së.

1/1


6. Radio Kaçaniku ka shprehur interesimin e tij për ripërtëritje të licencës.

Arsyëtimi

7. Neni 25 i Ligjit për KPM-në dhe Vendimi i Komisionit (KPM V3-2016), i datës 29 nëntor 2016, krijojnë bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje.

VENDIM

8. Komisioni merr VENDIM për ripërtëritjen e licencës së Radio Kaçaniku, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, me interes publik në zonën ku operon.
9. Licenca e transmetimit të KPM-së për Radio Kaçaniku do të jetë e vlefshme në afat prej 7 (shtatë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2016.
10. Të gjitha parametrat e licencës së KPM-së, si: Kategoria e të Licencuarit, Skema Programore, Parametrat Teknik si dhe Harta e Zonës së Mbulimit, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
11. Ky vendim hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI
KRYETAR
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.01.2017
Datë

1292.

Lloji i dërgesës
Vista postilike

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Oznachona vrednosti - postani iznos

nën numër _____
pod broj _____
për PAVO KRAČANIKU / BEDI ELSA
POJ VEČERERIS GATA P.Y / KRAČANIK
(Vendi)
(Mesto)

Poshtë i nënshkruari deklarion që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) _____ KAZIMIR ME NISYELIC
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (postani iznos) predatva uredno (placena: dano)

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca
Milica Krackanik
(Marrësi)

Vuq e postës së vendit
Peçat pošte


Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika pošte
Milica Krackanik
(Nënpunësi)
MB